



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit**  
**Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit**

Data	
Nr. Prot	

**RELACION**

**VENDIMI**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAMËZ, ME**  
**KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË**  
**SHQIPËRISË”, Z. SAJMIR MEHMET KURTI**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Me shkresën nr. 9111 prot., datë 30.10.2024, këshilli i bashkisë Kamëz, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Nertil Ilirian Sallo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Kamëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 22, z. Sajmir Mehmet Kurti.

Me shkresën nr. 3163, prot., datë 06.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, z. Sajmir Mehmet Kurti, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-3565\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Sajmir Mehmet Kurti, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 3366 prot., datë 27.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3367 prot., datë 27.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Sajmir Mehmet Kurti.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Sajmir Mehmet Kurti, në këshillin e bashkisë Kamëz

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Sajmir Mehmet Kurti.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Sajmir Mehmet Kurti, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Sajmir Mehmet Kurti, në këshillin e Bashkisë Kamëz, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

**Licela VELIU** -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

**Pavlina DOÇAJ** -Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA** -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: DD MM VVVV

Nr: 000 000

Ora: HH:MM

**VENDIM**

**PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAMËZ, ME**  
**KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË**  
**SHQIPËRISË”, Z. SAJMIR MEHMET KURTI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

**VËREJ:**

Me shkresën nr. 9111 prot., datë 30.10.2024, këshilli i bashkisë Kamëz, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Nertil Ilirian Sallo, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Kamëz, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 22, z. Sajmir Mehmet Kurti.

Me shkresën nr. 3163, prot., datë 06.11.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kamëz, z. Sajmir Mehmet Kurti, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-3565\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Sajmir Mehmet Kurti, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 3366 prot., datë 27.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3367 prot., datë 27.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Sajmir Mehmet Kurti.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Sajmir Mehmet Kurti, në këshillin e bashkisë Kamëz.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Sajmir Mehmet Kurti, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Sajmir Mehmet Kurti, në këshillin e Bashkisë Kamëz, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Kamëz, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Sajmir Mehmet Kurti.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**